REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA JURIDIKE

Shijak, më 14 .01. 2026

PROJEKT-VENDIM

"PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË TOTALE 15.010.285 (PESËMBËDHJETË MILION E DHJETË MIJË E DYQIND E TETËDHJETË E PESË) PËR LIKUJDIMIN E TË DËMTUARVE NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET E INTENSIVE TË DATËS 06.01.2026-10.01.2026"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 329, datë 16.05.2012 " Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare per mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njëzore" Kreu III e ne vijim i tij , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414 datë 08.07.2021"Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" , i ndryshuar .

I propozojmë këshillit të bashkisë;

PËR TË VENDOSUR:

1. Të miratojë ndihmën financiare me vlerë totale prej 15.010.285 (Pesëmbëdhjetë milion e dhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë për likujdimin e të dëmtuarve nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të datës 06.01.2026-10.01.2026.

2. Dhënia e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të datës 06.01.2026-10.01.2026 do të përballohen nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile (AKMC) .

3. Lista emërore bashkengjitur këtij projekt vendimi mbyllet me nr rendor 44 (Aneksi nr 1) .

Adresa:Lagja"Erzen"shijak,Tel:+355712252,ëëbsite:ëëë.shijak.gov.al,email:info@shijak.gov.al

Scanned with CamScanner

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe Sektori Planifikimit e Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave.

DREJTORIA JURIDIKE

Albiona Mehmeti

DREJTORIA EKONOMIKE

Pranvera Alushi

SEKRETARI I KËSHILLIT

Kozeta Doda

KRYETARI

Elton Arbana

BASHKIA SHIJAK

Scanned with CamScanner